

webermur blockset LW

Ilaç për ngjitje dhe suvatim të tullave silikate dhe blloqeve siporeks

■ Përshkrimi

webermur blockset LW është ilaç i thatë, i përbërë nga gëlqere e hidratuar, çimento Portland, inerte të zgjedhura dhe aditivë kimikë që përmirësojnë punueshmërinë dhe ngjitjen në tulla siporeks të llojeve të ndryshme. Në bazë të karakteristikave që kanë këto tulla, ky material realizon ngjitje shumë të mirë dhe rezistencë shumë të lartë mekanike.

■ Avantazhet

- Përdoret për tulla silikat dhe siporeks
- Ngjitshmëri perfekte me bazamentin
- 2 në 1 - për ngjitje dhe suvatim

■ Përdorimi

- Materiali përdoret si dorë e parë për suvatim në ambjente të brendshme dhe të jashtme duke u përdorur me pompë suvatimi apo dhe në mënyrë manuale.
- Përdoret si ilaç murature për struktura me tulla të lehtësuara dhe siporeks, gjithashtu dhe si ilaç mbushës për këto struktura. Nuk përdoret mbi suporte druri, gipsi metalike apo të lyera me bojra të ndryshme më parë.

■ Përgatitja e bazamentit

- Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë punës dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C,
- Muratura duhet të jetë e pastër nga pluhurat, papastërtitë, mbetje kripërash, mbetje vajrash, yndyrnash dhe dylli duhen hequr.

■ Udhëzime përdorimi

Për suvatim:

- Materiali i thatë përzehet me ujë të pastër në sasinë 24-25 litra ujë për 100 kg. Përzehet në makineri (pompë), ose me përzjerës mekanik, derisa të arrihet një masë homogjene e cila duhet të aplikohet brenda 2 orësh. Për spesorë më të mëdhenj se 20 mm aplikohet në më shumë se një shtresë, me distancë prej një ditë mes aplikimeve, duke patur kujdes të ashpërsoshet shtresa e suportit. Shtresa e parë duhet të ketë arritur tharjen e nevojshme për të mbajtur peshën e shtresës së dytë.

Për muraturë:

- Një thes material përzihet me rreth 6-6.5 litra ujë. Materiali përzihet me trapan ose mistri derisa të arrihet një masë homogjene. Pas përzierjes, materiali lihet të pushojë për rreth 10 minuta. Rifreskohet dhe një herë me mistri dhe aplikohet. Ilaçi pas përzierjes me ujin duhet të aplikohet brenda 2 orësh, në rast se është e nevojshme mund të riperzihet materiali herë pas here me një mistri.

■ Veglat

Për miksim: makineri, mikser elektrik

Për aplikim: pompe, mallë

■ Afati i përdorimit:

12 muaj, i ruajtur në ambient të thatë, në paleta druri. Data e prodhimit, shënuar në paketim.

*Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuar përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.



SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA sh.p.k
Rr. Budull, Nr.3 • 1039 Ahmetaq
Vore • Shqiperi
www.saint-gobain.com
NIPT : L61822023H

webermur blockset LW

Llaç për ngjitje dhe suvatim të tullave silikate dhe blloqeve siporeks

Tabela e të dhënave teknike

Lloji i paketimit	thes letre	
Sasi për njësi	25 kg / paketim 1500 kg / paletë	
Ngjyra	Gri	
Kokërrzimi	1.3mm	
Konsumi	14-15 Kg/m ²	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese dhe në varësi të karakteristikave të bazamentit dhe teknikës së aplikimit.
Konsumi i ujit	24-25 litra/100kg	
Trashësia e shtresës	10 mm	

Tabela e Performancës

PARAMETRAT	REZULTATI	NJËSIA
Rezistenca në përkulje 7 ditore	2 – 2,4	N/mm ²
Rezistenca në shtypje 7 ditore	3– 4	N/mm ²
Pesha volumore në gjendje të shkrifët	1,300-1400	g/cm ³
Raporti i përzjerjes me ujë	24-25	%

*Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuar përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.



SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA sh.p.k
Rr. Budull, Nr.3 • 1039 Ahmetaq
Vore • Shqiperi
www.saint-gobain.com
NIPT : L61822023H

webermur blockset LW